# Formular për SYLLABUS të Lëndës

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti Juridik – Universiteti i Prishtinës |
| Titulli i lëndës: | Kriminalistika |
| Niveli: | Bachelor |
| Statusi lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | II – Semestri IV |
| Numri i orëve në javë: | 2+1 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 6 |
| Koha / lokacioni: | |
| Mësimëdhënësi i lëndës: | Prof. Dr. Haki Demolli, Prof.Ass.Dr. Xhevdet Halili |
| Detajet kontaktuese: | hakidemolli@yahoo.com; xhevdet.halili@gmail.com |
| | |
| Përshkrimi i lëndës | Në kuadër të lëndës së Kriminalistikës, studentëve iu ofrohen njohuritë e përgjithshme mbi Kriminalistikën zanafillën, historikun, metodadt dhe objektin e saj shkencor. Përveç këtyre njohurive të përgjithshme, përpunohen edhe dy pjesët e rëndësishme të kriminalistikës dhe atë: Teknika Kriminalistike dhe Metodika Kriminalistike. |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimi kryesor i lëndës është që studentëve të fakultetit Juridik tiu ofrohen njohuri të përgjithshme mbi zbulimin, hetimin dhe sqarimin e krimit. Siq dihet studentët që përfundojnë këto studime mund të punësohen në institucione të ndryshme shtetërore të cilat ballafaqohen në mënyra të ndryshme me kriminalitetin. Si p.sh. në gjykata, polici, prokurori publike, avokati, ente për ekzekutimin e sankcioneve penale etj., andaj nkohuritë e fituara në lëndën Kriminalistika, atyre mund t'iu shërbejnë në masë të konsiderueshme në punën e tyre të përditshme për pengimin zbulimin dhe sqarimin e kriminalitetit. |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje, që:<br>1. Të përshkruaj dhe pjesërisht të përdorë disa mjete të teknikës kriminalistike që përdoren në fiksimin e gjurmëve të veprave penale në përgjithësi;<br>2. Të përshkruaj dhe pjesërisht të përdorë |

| | |
|---|---|
| | metodat shkencore për identifikimin e gjurëmve balistike;<br>3. Të përshkruaj dhe krahasojë metodat e teknikës së fotografisë që zbatohen në procesin e parandalimit dhe të luftimit të kriminalitetit;<br>4. Të hartojë tekstin dhe të zbatojë testimin poligrafik të personave të dyshimt për kryerjen e veprës penale;<br>*5.* Të zbatojë praktikisht ngacmimin e gjurmëve latente të gishtërinjëve, me metodën e brushës dhe të pluhurave magnetic. |

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithësej** |
|---|---|---|---|
| Ligjërata | **2** | **15** | **30** |
| Ushtrime teorike/laboratorike | **1** | **15** | **15** |
| Punë praktike | **2** | **15** | **30** |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | **0, 5-1** | **10** | **10** |
| Ushtrime në teren | **-** | **-** | **-** |
| Kollokfiume,seminare | **2** | **10** | **20** |
| Detyra të shtëpisë | **-** | **-** | **-** |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | **1.5** | **30** | **45** |
| Përgaditja përfundimtare për provim | **3** | **8** | **25** |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | **2** | **6** | **12** |
| Projektet,prezentimet ,etj | **2** | **6** | **10** |
| **Totali** | **6 ECTS** | **Total** | **180** |

| | |
|---|---|
| **Metodologjia e mësimëdhënies:** | Zakonisht do te aplikohën metoda bashkohore të ligjerimit, të cilat praktikohën në universitetët e ndryshme evropiane: prezentimi i temes përmes Power Point, raste studimi dhe detyra mesimore – studimore lidhur me temen e ligjeruar. Në disa raste atyre do të prezentohën edhe ligjerata autentike nga universitetet e ndryshme perendimore.<br>**Bashkëbisedim -** duke ju mundësuar studentëve parashtrimin e pyetjeve, diskutimin dhe këmbimin e mendimeve të tyre lidhur me qështjët e ndryshme tematike. |

| | |
|---|---|
| | **Aktivitete të studentëve -** studentët mund të përcaktohën për studimin e ndonjë teme apo punimi seminarik. Para fillimit të punës së tyre atyre ju ofrohën udhëzimët elementare, ndërsa pas përfundimit ju ofrohët mundësija e prezentimit të punimeve të tyre para studenteve te tjere. Pas prezentimit të ketyre seminareve zhvillohet debat interaktiv lidhur me temat e shtjelluara dhe në fund behet vlersimi i punimit.<br>**Debat shkencorë -** gjatë trajtimit te temave te ndryshme, studentët mund të ndahen ne dy ose me shumë grupe, më qëllim të zhvillimit të debateve interaktive dhe konstruktive shkencore. |
| | |
| **Metodat e vlerësimit:** | Mënyra e vlerësimit të studentit (në %)<br>▪ Punimi seminarik 0-10%<br>▪ Testi I 0-15 %<br>▪ Testi II 0-15%<br>▪ Provimi përfundimtar 0- 50%<br>▪ Pjesëmarrja në ushtrime 0 - 5%<br>▪ Puna grupore në detyra dhe raste studimi 0- 5% |

| Vleresimi ne % | Nota perfundimtare |
|---|---|
| 91-100 | 10 (dhjetë) |
| 81-90 | 9 (nëntë) |
| 71-80 | 8 (tetë) |
| 61-70 | 7 (shtatë) |
| 51-60 | 6 (gjashtë) |
| 0-50 | 5 (pesë) |

| **Literatura** | |
|---|---|
| **Literatura bazë:** | Kriminalistika, Një hyrje në shkencat ligjore, Richard Saferstein, Pearson Education, USA, 2014.<br>Criminal Investigation, eigth edition, Charles R. Swanson, Neil C. Chamelin, Leonard Territo, McGraw Hill Companies, USA, 2003.<br>Kriminalistika Vëllimi II, Prof.dr.Skënder Begeja, Tiranë, 2001.<br>Kriminalistika, Nedžat Korajlić, Prishtinë, 2009. |
| **Literatura shtesë:** | Ilir Mandro: Kriminalistika mbi identifikimin e armëve të zjarrit, Tiranë, 2000.<br>Ilir Mandro: Këqyrja e vendit të ngjarjes të në vrasjet me armë të zjarrit, Tiranë, 2000.<br>Estref Myftari: Këqyrja e Vendit të ngjarjes, Tiranë, |

| | |
|---|---|
| | 1996.<br>Skender Begeja: Mikrogjurmët dhe roli I tyre në procesin e të provuarit, Tiranë, 1989.<br>Haki Demolli: Terrorizmi, Prishtinë, 2002. |

| **Plani i dizejnuar i mësimit:** | |
|---|---|
| **Java** | **Ligjerata që do të zhvillohet** |
| ***Java e parë:*** | Njohuritë e përgjithshme mbi kriminalistikën;<br>- Detyra, Objekti, dhe metodat e Kriminalistikës<br>- Zhvillimi i Kriminalistikës;<br>- Shkenca e kriminalistikës në luftimin e kriminalitetit<br>- Parimet dhe sistemi i Kriminalistikës. |
| ***Java e dytë:*** | – Njohuritë e përgjithshme mbi teknikën kriminalistike;<br>- Kuptimi dhe detyrat e teknikës kriminalistike<br>- Ndarja e teknikës kriminalistike<br>- Teknika regjistruese kriminalistike dhe regjistrimi kriminalistik<br>- Zhvillimi i metodave të regjistrimit kriminalistik<br>- Fotografia regjistruese dhe përshkrimi i personit |
| ***Java e tretë*:** | - Bazat shkencore të Identifikimit kriminalistik<br>- Objektet e identifikimit kriminalistik;<br>- Identifikimi i personave në bazë të tipareve të jashtme<br>- Antropometria;<br>- Fotografia e përshkruar;<br>- Identifikimi i personit në bazë të gjurmës gjenetike (ADN). |
| ***Java e katërt:*** | Bazat e fotografisë kriminalistike<br>- Kuptimi dhe llojet e fotografisë kriminalistike<br>-Metodat kryesore të fotografisë kriminalistike<br>- fotogrametria;<br>- Fotografia sinjaletike, Holografia, makro dhe mikrofotografia<br>- Fotografia me rreze infra të kuqe dhe ultra violete etj. |
| ***Java e pestë:*** | - Traseologjia dhe studimi mbi gjurmët<br>- Kuptimi I gjurmëve në Kriminalistikë<br>- Metodat e fiksimit të gjurmëve të veprës penale<br>-Detyrat dhe parimet e traseologjisë<br>- Mekanizmi I formimit të gjurmëve traseologjike;<br>- Klasifikimi I gjurmëve<br>- Gjurmët e veglave të thyerjes dhe mjeteve të transportit. |
| ***Java e gjashtë*:** | Rëndësia e daktiloskopisë në ndriçimin e veprave penale<br>- Historiku i daktiloskopisë<br>- Karakteristikat e vijave papilare;<br>- Ndarja e daktiloskopisë |

| | |
|---|---|
| | - Metodat e zbulmit dhe fikismit të vijave papilare<br>Gjatë orës së dytë do të ndahen studentët në grupe të vogëla dhe do të bëhet demonstrimi praktik i fiksimit të vijave paiplare si dhe e daktiloskopimit të personave, ku një numri të madh të studentëve do tiu jepet mundësia për veprim vetanak. |
| ***Java e shtatë:*** | Gjatë orës së parë do të bëhet vlerësimi i parë intermediar, permes kollokiumit i cili do të përmabj 20 pyetje që kanë të bëjnë me çështjet e ligejruara në gjashtë ligjeratat e para. Disa pyetje do të jenë të sistemit shumë zgjedhës, disa të tjera sutdenti për tu përgjegjur duhet të bëjë plotësimet e kërkuara.<br>Gjate orës së dytë do të shtjellohen:<br>- Gjurmët e këmbëve të njeriut,<br>- Gjurmët e gjakut dhe të spermës;<br>- Mikrogjurmët (flokëve, ngjyrave, pluhurit) |
| ***Java e tetë:*** | Njohuritë mbi balistikën kriminalistike<br>- Kuptimi dhe ndarja e balistikës kriminalistike<br>- Klasifikimi i armëve të zjarrit<br>- Zbulimi dhe fiksimi i gjurmëve të armëve të zjarrit;<br>-Përcaktimi i rrethanave të qitjes më armë të zjarrit<br>- Ekspertimi balistik kriminalistik |
| ***Java e nëntë:*** | Detektori i genjeshtrës – poligrafi<br>- Studentëve do t'iu përgatitet rasti në mënyrë që ata të hartojnë pyetjet për testimin poligrafik (në dispozicion kanë 25 minuta), pastaj do të bëhet interpretimi I rezultateve si dhe do tiu bëhet me dije në mënyrën konkret se si është dashur të hartohet testi)<br>- Pjesët dhe funksionimin e poligrafit<br>- Shfrytëzimi i rezultateve të testimit poligrafik në procedurën penale dhe sfera të tjera të jetës (punësim etj). |
| ***Java e dhjetë:*** | Kuptimi i metodikës kriminalistike;<br>- Metodika e zbulimit dhe sqarimit të vrasjeve<br>- Kuptimi dhe llojet e vrasjeve;<br>- Veprimet kryesore hetimore në sqarimin e vrasjeve;<br>- Këqyrja e vendit të ngjarjes të vrasjet<br>-Llojet e vetvrasjeve. |
| ***Java e njëmbedhjetë*:** | Metodika e zbulimit të vjedhjeve;<br>- Kuptimi dhe llojet e vjedhjeve<br>- Vjedhjet me thyerje; grabitjet, vjedhjet në xhepa<br>Metodika e zbulimit të kriminalitetit ekonomik<br>- Kuptimi dhe shkaqet e krimianlitetit ekonomik<br>- Format e kriminalitetit ekonomik |

| | |
|---|---|
| | - Specifikat e zbulimit dhe sqarimit të kriminalitetit ekonomik |
| ***Java e dymbëdhjetë*:** | Metodika e zbulimit të krimeve seksuale;<br>Karakteristikat e kryerësve dhe të viktimave të krimeve seksuale<br>Koha dhe vendi i ngjarjes të krimeve seksuale<br>Veprimet hetimore në zbulimin e krimeve seksuale.<br>Metodika e zbulimit të kriminalitetit kompjuterik<br>- Format e paraqitjes së kriminalitetit kompjuterik<br>- Aspekti penalo juridik i kriminalitetit kompjuterik<br>- Specifikat e zbulimit të kriminalitetit kompjuterik |
| ***Java e trembëdhjetë*:** | Metodika e zbulimit të kriminalitetit të organizuar<br>- Kuptimi dhe llojet e kriminalitetit të organizuar<br>- Ndriçimi i kontrabandës me narkotikë;<br>- Ndriçimi i kontrabandës me automjete<br>- Ndriçimi i kontrabandës me qenie njerëzore<br>- Ndriçimi i kontrabandës me armë të zjarrit<br>- Ndriçimi i kontrabandës me vlera kulturore<br>- Zbulimi dhe luftimi i korrupsionit si formë e krimit të organizuar. |
| ***Java e katërmbëdhjetë*:** | Metodika e zbulimit dhe sqarimit të falsifikimit të dokumentave, monedhave dhe letrave me vlerë<br>- Llojet e falsifikimit;<br>- Mjetet dhe metodat më të shpeshta që përdoren për zbulimin e falsifikimit<br>- Ekzaminimi grafik dhe i shkrimit<br>Pas orës së dytë jepen nënshkrimet për studentët e rregulltë |
| ***Java e pesëmbëdhjetë*:** | Perseritje e njesive mesimore, ne forme te pyetjeve nga studentet dhe pergjegjjeve nga mesimdhenesi dhe anasjelltas. |

| **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:** |
|---|
| E gjithë puna e studentit duhet të jetë e pavarur. Studentët duhet të njihen me Kodin etik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", i cili kërkon që të gjithë, studentët dhe personeli akademik të ruajnë standardet më të larta të ndershmërisë dhe integritetit akademik. Mashtrimi, plagjiatura, gënjeshtra dhe vjedhja janë rreptësisht të ndaluara. Të gjitha shkeljet e Kodit Etik do t'i raportohen Komisionit disiplinor. |